



Prishtinë: 31.01.2022

Kodi i ZRRE-së: V_1481_2022

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2273_12_21** të dt. 13.12.2021;
- Ankesën e konsumatorit të dt. 10.01.2022;

në seancën e mbajtur më datë 31.01.2022 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar ankesa e konsumatorit B.S nga Komuna e Prizrenit.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK_V_2273_12_21, i datës 13.12.2021.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtje të Konsumatorëve në ZRrE me datë 13.12.2021 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK_V_2273_12_21, me të cilin e ka refuzuar ankesën e konsumatorit B.S nga Komuna e Prizrenit, lidhur me kontestimin e faturës për periudhën mars 2020, për shkak të dyshimit të leximit dhe faturimit jo të saktë të njehsorit elektrik nr. 64653534.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori B.S, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRrE-së për këto shkaqe:

- Shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës ligjore;
- Vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike;
- Shkeljeve të dispozitave të së drejtës materiale;
- Shkeljeve të afateve ligjore dhe
- Se Vendimi i kontestuar nuk është nxjerr në pajtim me qëllimin e ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme në Republikën e Kosovës.
- Konsumatori pretendon që, në vendimin e kontestuar nuk është vërtetuar drejtë gjendja faktike, sepse shpenzimi i energjisë elektrike nuk është bërë, pasi që ka jetuar jashtë vendit;
- Konsumatori i propozon Bordit që ta anuloj vendimin e shkallës së parë në ZRrE – Departamentit për Mbrojtje të Konsumatorëve ;

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 31.01.2022 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për



Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimin e konsumatorit se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë në ZRrE përmban shkelje esenciale të dispozitave ligjore dhe vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, Bordi i ZRrE-së, pas analizimit të të gjitha shkresave të lëndës, një nga një dhe në ndërlidhje me njëra tjetrën, ka gjetur se, ankesa e konsumatorit duhet të refuzohet si e pa bazuar. Sepse, Bordi me kujdes dhe ndërgjegje ka analizuar dhe çmuar të gjitha provat relevante, si në vijim: Faturën e dt. 26.03.2020; Ankesën e konsumatorit në KESCO të dt. 05.08.2020; Procesverbalin e inspektimit të dt. 06.08.2020; Përgjigjen e KESCO-s të dt. 13.08.2020; Listat e leximit dhe rrjedha e energjisë elektrike; Ankesën e konsumatorit të dt. 26.01.2021; Vendimin e DMK-së të dt. 13.12.2021 dhe ankesën e konsumatorit të dt. 10.01.2022, dhe ka gjetur se, Departamenti i Faturimit në KESCO me datë 26.03.2020 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën mars 2020 me 2,283 kWh apo e shprehur në vlerë financiare në shumën prej 130.87 EUR. I pa kënaqur me këtë faturim, konsumatorit ka parashtruar ankesë tek i licencuarit KESCO, e cila ankesë ishte refuzuar paraprakisht, dhe me pas, duke ndjekur procedurën ligjore në fuqi, ankesën e tij e ka adresuar në ZRrE.

Bordi ka analizuar me kujdes Procesverbalin e inspektimit të dt. 06.08.2020, ka gjetur se, shpenzimet e evidentuara në procesverbalin e inspektimit përputhen plotësisht me shpenzimet e konsumatorit të evidentuara në CCP (Customer Care Package) për periudhën korrik 2020.

Më tej, Bordi po ashtu ka analizuar edhe rrjedhën e energjisë elektrike si dhe listat e leximit, për periudhën kontestuese dhe ka gjetur se për periudhën kontestuese, lexuesi i KEDS-it ka bërë inspektime të rregullta mujore dhe se në disa periudha është evidentuar që nuk ka qasje në leximin e njehsorit elektrik, dhe i ka sugjeruar konsumatorit që të bëhet zhvendosja e njehsorit elektrik, pasi që konsumatori jeton jashtë shtetit.

Duke u bazuar në rrjedhën e energjisë elektrike, Bordi ka gjetur se shpenzimi i faturuar për periudhën mars 2020 (periudha kontestuese) nuk përputhet me shpenzimet e mëhershme të konsumatorit dhe ato të mëvonshme, dhe për këtë qëllim, Departamenti për Mbrojtje të Konsumatorëve në ZRrE e ka bërë shpërndarjen e kilovatëve për periudhën shtatë (7) mujore, gjegjësisht nga 01/2020 deri në periudhën 07/2020. Kjo për faktin se, për periudhat 04/05//06/2020 ishte faturuar vetëm me taksa, sepse punëtorët e autorizuar të KEDS-it, nuk kanë pasur qasje në njehsorin e konsumatorit. Mos ofrimi i qasjes në pikën matëse është në kundërshtim me nenin 25 par. 1 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, e që në mënyrë decisive parashihet si vijon: *“Konsumatori është i obliguar që t’i lejojë qasje në pronën e tij përfaqësuesve të OSSh-së/Furnizuesit, me qëllim të leximit, testimit, inspektimit, instalimit, mirëmbajtjes, riparimit të matësve, kyçjeve dhe pajisjeve përkatëse ...”*. Rrjedhimisht, pasi që nuk ishte evidentuar asnjë parregullsi, dhe se faturimi është i bazuar në shpenzimin e energjisë elektrike të regjistruar në pikën matëse, Bordi konstaton se, nuk ka faturim me tepër se sa shpenzimi që është bërë, dhe se po ashtu, nuk është evidentuar ndonjë gabim në lexim. Andaj, Bordi thekson se, vendimi i DMK-së është i bazuar në gjendjen faktike dhe provat materiale si në shkresat e lëndës, dhe pretendimet tjera të konsumatorit, janë të pabazuara dhe si të tilla nuk qëndrojnë.



Duke u bazuar në nenin 28 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, në të cilën thuhet se: *“Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar dhe për tarifën tjetër, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar për konsumatorin (nëse është e aplikueshme) dhe se faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit, duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi, ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatorit për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit”,* Bordi ka gjetur se, i licencuari KESCO ka vepruar në harmoni me obligimet e tij ligjore, dhe përfundimisht, duke u bazuar në të gjitha të thënat si më sipër, u vendos si më sipër.

Andaj, në harmoni me nenin 48 të Ligjit nr.05/L-031 të Procedurës së Përgjithshme Administrative, Bordi i ZRRE-së i ka vlerësuar të gjitha pretendimet e ankuesit dhe i ka analizuar të gjitha dëshmitë dhe provat që lidhen më rastin në fjalë dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 31.01.2022 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.



Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-së,
- Konsumatorit B.S dhe
- Arkivit të ZRRE-së.